



European  
Union  
Kosovo

# Ndikimi i taksës 100%

## në prodhim dhe çmime të produkteve në Kosovë

Periudha krahasuese: janar - tetor 2019 dhe janar - tetor 2018



Mars 2020

KOSOVO 2.0

INSTITUTI GAP  
GAP INSTITUTE 

**Ndikimi i taksës 100% në prodhim  
dhe çmime të produkteve në Kosovë**  
Periudha krahasuese: janar - tetor 2019  
dhe janar - tetor 2018

—  
Mars 2020

— **Përmbajtja**

**3** Përmbledhje ekzekutive

**4** Importet nga Serbia dhe Bosnja  
dhe Hercegovina në Kosovë para  
dhe pas tarifës 100%

**6** Importi i produkteve kryesore nga  
Serbia dhe BiH në vitin 2019

**7** Ndikimi i taksës në prodhimin e  
brendshëm në Kosovë

**13** Përfundim

## Përmbledhje ekzekutive

Qeveria aktuale, konkretisht kryeministri Kurti, në shkurt 2020 ka prezantuar propozimin për heqje të tarifës 100% për lëndën e parë që importohet nga Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina duke filluar nga 15 marsi 2020.<sup>1</sup> Si hap i dytë ishte propozuar heqja e tërësishme e tarifës<sup>2</sup> për të gjitha produktet nga këto dy vende nga 1 prilli 2020 për një periudhë prej 90 ditësh. Mirëpo, edhe pse ka kaluar afati në fjalë, qeveria nuk ka marrë vendim për heqjen e tarifës në lëndën e parë dhe tarifa mbetet ende në fuqi. Konkretisht, nga 21 nëntori 2018, Kosova aplikon tarifë 100% për produktet që importohen nga Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina (BiH).<sup>3</sup> Kësaj tarife i kishte paraprirë masa e mëhershme ku aplikohet 10% tarifë në produktet e importuara nga këto dy vende. Vendimi për aplikimin e tarifës 100% ishte i karakterit politik dhe pasoi një ditë pasi që Kosova kishte dështuar të anëtarësohej në Interpol. Deri atëherë, Serbia ishte eksportuesi kryesor në Kosovë, mirëpo në të njëjtën kohë ajo mbetej edhe shteti që aplikonte më së shumti barriera tregtare për bizneset kosovare që eksportonin atje.<sup>4</sup> Vendosja e tarifës ka paraqitur sfidë për një pjesë të prodhuesve në Kosovë, për shkak të varësisë së tyre nga lënda e parë që vinte nga Serbia dhe për importuesit e produkteve finale. Përveç nevojës për të zëvendësuar produktet e importuara nga Serbia, bizneset janë përballur edhe me rritje të kostos së transportit. Gjithsesi, për palët tjera - bizneset vendore dhe importuesit në Kosovë të cilët importojnë nga vendet tjera - tarifa ka paraqitur mundësi për rritjen e prezencës së tyre në treg.

Kjo analizë synon të vlerësojë ndikimin e tarifës 100% në prodhimin dhe çmimet e produkteve në Kosovë. Duke përdorur indikatorë direkt dhe të tërthortë lidhur me veprimtarinë e industrisë përpunuese, kemi vlerësuar rritjen e prodhimit në Kosovë. Ndërsa, bazuar në indekset e çmimeve të konsumit dhe importit për Kosovën dhe vendet e Bashkimit Evropian, kemi tentuar që të izolojmë faktorët që kanë ndikuar në rritjen e hovshme të çmimeve të konsumit në Kosovë pas vendosjes së tarifës 100%. Analiza është vazhdimësi e analizës së parë të Institutit GAP lidhur me efektet e tarifës 100% në prodhimin e brendshëm dhe çmime në Kosovë, mirëpo që mbulon një periudhë krahasuese më të madhe.<sup>5</sup>

Të gjeturat tregojnë se importet e produkteve nga Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina kanë rënë drastikisht pas hyrjes në fuqi të tarifës 100%, ku nga rreth 450 milionë euro në vit që importonte Kosova nga Serbia para tarifës, në vitin 2019, vlera totale e importeve ka rënë në rreth 5.8 milionë euro. Ndërsa, në rastin e BiH, vlera e importeve ka rënë nga rreth 81 milionë euro në vit në të kaluarën, në vetëm 2.2 milionë euro në vitin 2019. Nga vendet që kanë pasur një rritje më të theksuar pjesëmarrjen e tyre në importin total të Kosovës janë Greqia, Maqedonia e Veriut, Bullgaria, dhe më shumë. Ndërsa, eksportet e Kosovës drejt Serbisë dhe BiH, edhe pse kanë pësuar rënie, ajo nuk ka qenë aq e theksuar sikur në rastin e importit nga këto dy vende. Vlera e produkteve të eksportuara drejt Serbisë nga Kosova gjatë 2019 ishte rreth 17% më e ulët, nga 27 milionë euro në 2018 në 22.8 milionë euro në 2019. Ndërsa, vlera e produkteve të eksportuara drejt BiH nga Kosova gjatë 2019 ishte rreth 28% më e ulët se në 2018, nga 6.7 milionë euro në 2018 në 4.8 milionë euro në 2019.

1 Zyra e Kryeministrit. Kryeministri Kurti: Nga 15 mars 2020, hiqet tarifa për lëndën e parë që importohet nga Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina. Burimi: <https://bit.ly/2vfF2XA>

2 Në këtë analizë termet tarifë, taksë, ose masë mbrojtëse kanë kuptimin e njëjtë dhe i referohen taksës 100.

3 Qeveria e Kosovës. Vendimi 1/76, 21.11.2018. Burimi: <https://bit.ly/2TRoDOc>

4 Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, "Barrierat Tregtare, Lehtësimi i tregtisë si mjet për eliminimin e tyre", Prill 2018, Burimi: <http://bit.ly/2VdJmS>

5 Analizën e plotë e gjeni këtu: <https://bit.ly/2wXyFsj>

Importi total i Kosovës në 2019 ishte rreth 3.5 miliardë euro apo 4% më i lartë se në 2018, që paraqet një rritje më të ngadalësuar të importeve për dallim nga 2018 dhe 2017. Kurse, eksporti total në 2019 ishte rreth 350 milionë euro apo rreth 6% më i lartë se në 2018. Deficiti tregtar mbetet thuajse njëjtë si në vitet e kalura ku shkalla e mbulueshmërisë së importeve me eksporte mbetet rreth 10%.<sup>6</sup>

Sa i përket ndikimit të tarifës 100% në prodhimin e brendshëm në Kosovë, analiza gjen se ka një rritje të aktivitetit në sektorin e prodhimit (industrinë përpunuese), por që është jo e theksuar dhe me trend më të ulët se në periudhën para vendosjes së tarifës. Konkretisht, gjatë periudhës janar - shtator 2019 ky sektor kishte rritje për 10%, ndërsa në periudhën e njëjtë në vitin 2018 rritja e industrisë përpunuese ishte 16%. Në terma real, industria përpunuese ka shënuar një rritje mesatare prej 6.5% gjatë 2019 krahasuar me 2018.7 Po ashtu, konsumi i energjisë elektrike nga ky sektor është rritur për rreth 9.8% krahasuar me vitin 2018.8 Për më shumë, trendi i punësimit mesatar përgjatë muajve të vitit 2019 ka ndjekur trendin e viteve të kaluara, duke mos pasur ndonjë devijim nga cikli i rënieve dhe ngritjeve të numrit të të punësuarve. Konkretisht, gjatë vitit 2019, numri i punonjësve në sektorin e industrisë përpunuese është rritur në mesatare për 7%, ndërsa në 2018 rritja ishte 10%.

Por, një ndikim më i theksuar i tarifës 100% vërehet në çmimet e produkteve gjatë vitit 2019. Rritjen më të theksuar e kishin çmimet e ushqimit dhe pijeve, të cilat janë rritur për rreth 6.1% në periudhën janar - shtator 2019 krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018, që ishte edhe rritja më e lartë nga 2017. Rritja e çmimeve ishte e menjëhershme dhe më dominante në gjashtëmujorin e parë pas vënies së tarifës. Në pjesën e dytë të vitit 2019, vërehet një tendencë rënëse e çmimeve krahasuar me periudhën e njëjtë 2018, mirëpo çmimet përsëri kanë qenë më të larta për rreth 3.3%.

## Importet nga Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina në Kosovë para dhe pas tarifës 100%














Gjatë vitit, Kosova importonte nga Serbia vlerë të lartë të produkteve sikurse lëndët djegëse, pijet, drithërat, vajrat, dhe më shumë, ku varësia në import për ato produkte nga Serbia shkonte deri në 85%. Gjatë vitit 2019, në periudhë krahasuese të njëjtë me atë të 2018, konkretisht janar - tetor, nga Tabela 1, vërehet se për të gjitha këto produkte, Kosova ka rritur vlerën e importuar duke i zëvendësuar kështu ato me produkte nga vendet tjera. Nga 83 milionë euro lëndë djegëse që importoheshin nga Serbia në vitin 2018, gjatë vitit 2019 janë importuar rreth 90 milionë euro nga Greqia dhe Sllovenia. Ngjashëm, derisa në janar - tetor 2018 nga Serbia importoheshin mbi 26 milionë euro drithëra, në vitin 2019, mbi 20 milionë euro drithëra kanë si origjinë Kroacinë dhe Bullgarinë. Në përgjithësi, për gjashtë grupet kryesore të produkteve të importuara nga Serbia, tani origjinë e importit janë kryesisht Maqedonia e Veriut, Bullgaria, Greqia dhe Kroacia.

6 Të dhënat e Doganës së Kosovës, për periudhën janar - tetor 2018 dhe janar - tetor 2019.

7 Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. Raport - Vlerësimi i ndikimit të "Programi për Zhvillimin e Ndërmarrjeve". Burimi: <https://bit.ly/38RW0oX>

8 Agjencia e Statistikave të Kosovës. Bilanci i Energjisë në Kosovë. 2017-2019.

**Tabela 1. Pjesëmarrja e Serbisë në importin e Kosovës në disa sektorë**

TARIK <sup>9</sup>	Importi nga Serbia janar - tetor 2018 (euro)	Importi total i Kosovës, janar - tetor 2018 (euro)	Pjesëmarrja e Serbisë në importin total	Importi total i Kosovës, janar - tetor 2019 (euro)	Rritja e pjesëmarrjes në importin total të Kosovës e disa vendeve në 2019:
27. Lëndët djegëse	83,664,574	369,545,247	23%	378,423,911	 Greqia <b>+105%</b> (+57 mil.),  Sllovenia <b>+257%</b> (+33 mil.)
22. Pijet	32,867,622	63,297,751	52%	65,151,129	 Maqedonia e V. <b>+294%</b> (+11 mil.),  Bullgaria <b>+9709%</b> (+14 mil.)
10. Drithërat	26,123,910	30,893,797	85%	33,420,158	 Kroacia <b>+2736%</b> (+13.4 mil.),  Bullgaria <b>+4798%</b> (+6.8 mil.)
15. Vajërat	12,861,448	23,810,846	54%	24,701,246	 Bullgaria <b>+304%</b> (+5.3 mil.),  Maqedonia e V. <b>+443%</b> (+5.7 mil.)
17. Sheqerërat	12,785,439	23,614,312	54%	24,955,757	 Franca <b>+23687%</b> (+6.4 mil.),  Polonia <b>+115%</b> (+2.8 mil.)
23. Ushqim për kafshë	11,357,751	17,047,701	67%	13,228,832	 Kroacia <b>+272%</b> (+2 mil.),  Greqia <b>+118%</b> (+ 900 mijë.),  Bullgaria <b>+345%</b> (+112 mijë)










Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e Doganës së Kosovës

Vënia e tarifës 100% për mallrat nga Serbia dhe BiH, ka ndikuar që të rritet prezenca e importeve nga vendet tjera në shkallë shumë të lartë. Në vitin 2019, Bullgaria ka eksportuar në Kosovë rreth 58 milionë euro apo 87% më shumë së në vitin paraprak. Greqia mbi 72 milionë euro apo 58% më shumë, Kroacia rreth 42 milionë euro apo 43% më shumë dhe Maqedonia e Veriut mbi 68 milionë euro apo 40% më shumë. Për shumicën nga sektorët në të cilat Serbia ka mbuluar pjesën më të madhe të importit në Kosovë, vërehet një vlerë më e lartë e importit gjatë 2019, që tregon se bizneset në Kosovë kanë arritur që të gjejnë burime tjera për import, ashtu siç theksohet edhe në analizën e mëhershme të Institutit GAP.

Produktet të cilat importoheshin më shumë nga Bosnja dhe Hercegovina para tarifës 100%, ishin në masë më të madhe hekuri dhe çeliku, si dhe ushqimet e mishit dhe peshkut, dhe produktet bulmetore. Në 2019, ka rënë importi total i Kosovës për këto produkte dhe pjesa më e madhe e importeve që më parë mbulohehin nga BiH tani importohen nga Turqia e cila ka rritje prej mbi 15 milionë euro apo 731% dhe Greqia me 6 milionë apo 98%. Ndërsa, për produktet e mishit dhe bulmetore të importuara më herët nga Bosnja dhe Hercegovina, ato janë mbuluar kryesisht nga Sllovenia dhe Maqedonia e Veriut.

9 Tarifa e Integruar e Kosovës (TARIK) bazohet në sistemin e harmonizuar dhe nomenklaturën e kombinuar për klasifikimin e mallrave

**Tabela 2. Pjesëmarrja e BiH në importin e Kosovës në disa sektorë**

TARIK	Importi nga Bosnja, janar - tetor 2018 (euro)	Importi total i Kosovës, janar - tetor 2018 (euro)	Pjesëmarrja e Bosnjës në importin total	Importi total i Kosovës, janar - tetor 2019 (euro)	Rritja e pjesëmarrjës në importin total të Kosovës e disa vendeve në 2019:
72. Hekuri dhe çeliku	27,146,494	183,885,699	15% 	171,993,390	 Turqia <b>+731%</b> (+ 15 mil. euro),  Greqia <b>+98%</b> (+6 mil.)
16. Ushqimet e përgatitura prej mishit, peshkut, etj.	6,588,334	22,773,034	29% 	25,038,223	 Sllovenia <b>+130%</b> (+5.5 mil.),  Maqedonia e V. <b>+30%</b> (+500 mijë)
4. Produktet bulmetore	4,963,134	39,749,246	12% 	41,232,340	 Maqedonia e V. <b>+64%</b> (+ 2.1 mil.),  Sllovenia <b>+18%</b> (1.7 mil.)

Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e Doganës së Kosovës

## Importi i produkteve kryesore nga Serbia dhe BiH në vitin 2019

Pas vënies së tarifës 100%, produktet kryesore që vazhdojnë të importohen nga Serbia, siç tregon Tabela 3, janë produktet farmaceutike, energjia elektrike dhe karburante e makineri. Ndërsa nga Bosnja dhe Hercegovina kanë vazhduar të importohen kryesisht produkte për përgatitje të ushqimeve nga mishi, perimet dhe frutat. Elementet që mund të ndikojnë në importin e këtyre produkteve mund të jenë qoftë vështirësia në zëvendësimin e tyre nga tregjet tjera apo edhe nevoja për importimin e këtyre produkteve në kohë më të shpejtë.

**Tabela 3. Importet nga Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina në Kosovë në 2019**

Importet kryesore nga Serbia në 2019	Vlera (€)	Importet kryesore nga BiH 2019	Vlera (€)
30. Produkte farmaceutike	935,534	16. Ushqimet e përgatitura prej mishit dhe peshkut	1,318,852
27. Lëndët djegëse minerale (Energji elektrike dhe karburante)	501,762	20. Përgatitje prej perimeve, frutave apo pjesëve të tjera të bimëve	397,531
28. Kimikatet inorganike (oksigjen)	482,772	25. Kripërat, gëlqere dhe çimento	123,968
85. Makineri dhe pajisje elektrike (për TV)	417,343	19. Përgatitjet prej drithërave, produktet e pastičerisë apo prej brumërave	71,949
84. Makineri dhe kaldajat (bojlerët)	391,507	73. Hekur dhe çelik	42,128
7. Hekur dhe çelik	342,919	44. Druri dhe artikujt prej druri	33,755
10. Drithërat	300,277	30. Produktet farmaceutike	33,416
<b>Total importi në 2019</b>	<b>5,792,645</b>	<b>Total importi në 2019</b>	<b>2,148,743</b>

Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e Doganës së Kosovës


## Ndikimi i taksës në prodhimin e brendshëm në Kosovë

Për të analizuar ndikimin e taksës në prodhimin e brendshëm në Kosovë, kemi analizuar indikatorë të ndryshëm të cilët reagojnë drejtpërdrejt nga rritja e aktivitetit në sektorin e prodhimit. Konkretisht, janë përdorur indikatorë lidhur me qarkullimin e bizneseve nga ky sektor, shpenzimi i energjisë elektrike dhe numri i të punësuarve në këtë sektor.

### Qarkullimi i bizneseve në sektorin e industrisë përpunuese

Gjatë vitit 2019, konkretisht në periudhën janar - tetor 2019, sipas të dhënave të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), qarkullimi i deklaruar bizneseve nga industria përpunuese është rritur për 10%.<sup>10</sup> Rritja në këtë periudhë është më e ulët se në vitin 2018, kur, krahasuar me 2017, rritja ishte rreth 16%. Gjatë tërë vitit 2019, e gjithë industria përpunuese e përbërë nga rreth 5 mijë biznese<sup>11</sup>, ka realizuar një qarkullim më të lartë për rreth 130 milionë euro, ndërsa në 2018 kishte realizuar qarkullim më të lartë për mbi 170 milionë euro. Një rritje më e theksuar e aktivitetit të bizneseve prodhuese në Kosovë, të cilat kanë pasur një avantazh të madh me vënien e tarifës 100%, do të duhej të ishte shprehur në rritje më të madhe të këtij sektori, Sidomos në muajt e fundit të vitit 2019, pasi që në muajt e parë mund të ndodhë që efektet të mos vërehen për shkak të kohës që u duhet prodhuesve qoftë në rritjen e kapaciteteve prodhuese - përkundër që shumica e tyre deklarohen se operojnë nën kapacitetin e instaluar - gjetjen e fuqisë punëtore, e faktorë të tjerë.<sup>12</sup> Ngjashëm, edhe rritja e numrit të të punësuarve në këtë sektor është në kufijtë e rritjes normale vjetore. Konkretisht, gjatë periudhës janar - tetor 2019, numri i punonjësve në sektorin e industrisë përpunuese është rritur për 7%, ndërsa në janar - tetor 2018 rritja ishte 10%. Për më shumë, trendi i punësimit mesatar përgjatë muajve në 2019 ka ndjekur trendin e viteve të kaluara, duke mos pasur ndonjë devijim nga cikli i rënieve dhe ngritjeve të numrit të të punësuarve.

**Figura 1.** Qarkullimi dhe numri mesatar i punonjësve në industrinë e prodhimit në Kosovë, 2017-2019



Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e ATK

<sup>10</sup> Të dhënat janë pranuar përmes kërkesës.

<sup>11</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës. Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve.

<sup>12</sup> Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. Raport - Vlerësimi i ndikimit të "Programi për Zhvillimin e Ndërmarrjeve".


Burimi: <https://bit.ly/38RWOoX>

Në terma real, sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), industria përpunuese ka shënuar një rritje mesatare gjatë periudhës janar - shtator 2019 prej 6.5% krahasuar me 2018. Ndërsa rritja mesatare reale e sektorit në periudhën janar - shtator 2018 krahasuar me 2017, ka qenë rreth 3.7%. Konkretisht, në 2019, sektori i industrisë përpunuese fillimisht kishte një aktivitet më të vogël në tremujorin e parë me vetëm 2% rritje krahasuar me 2018, ndërsa në tremujorin e dytë dhe të tretë vërehet një rritje reale më e theksuar e këtij sektori me 10.6% dhe 6.86% respektivisht.<sup>13</sup>

## Konsumi i energjisë elektrike

Konsumi i energjisë elektrike në vitin 2019 nga konsumatorët e mëdhenj sikurse Ferronikeli, Trepça dhe Sharrceci, së bashku me sektorin e industrisë vërehet se është më i lartë se në vitin 2018 për rreth 24%. Mirëpo, siç tregon Figura 2 vërehet se në periudhën 2017-2019 ka luhajtje të mëdha mes konsumit të tremujorëve gjatë viteve të ndryshme. Kjo në masë të madhe mund të ndikohet edhe nga operimi i konsumatorëve të mëdhenj sikurse Ferronikeli, i cili në të kaluarën, përfshirë vitin 2019, në disa raste gjatë vitit e ka ndalur tërësisht prodhimin.<sup>14</sup> Andaj, nëse e veçojmë sektorin e industrisë, vërejmë se ekziston një cikël i njëjtë i konsumit të energjisë nga ky sektor përgjatë tremujorëve, me një tendencë rritjeje. Konkretisht, gjatë 2019 konsumi i energjisë elektrike nga sektori i industrisë është rritur për rreth 9.8% për dallim nga 2018, ndërsa në 2018 rritja ishte rreth 5% ose 4.8 pikë përqindje më e ulët.

**Figura 2.** Konsumi i energjisë elektrike nga të gjithë prodhuesit dhe vetëm nga industria, 2017-2019



Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e ASK

Shënim: 2017\_pa - 2019\_pa nuk përfshijnë konsumatorët e mëdhenj sikurse Ferronikeli

<sup>13</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës. Bruto Produkti Vendor (BPV) me Qasjen e Shpenzimeve dhe të Prodhimit, TM3 2019. Burimi: <https://bit.ly/33bhJLf>

<sup>14</sup> Zëri. "Ferronikeli" që më shumë se dy muaj jashtë prodhimit. Burimi: <https://bit.ly/38IVFZA>




## Ndikimi në çmimet e produkteve ushqimore

Vendosja e tarifës ka paraqitur sfidë për një pjesë të prodhuesve në Kosovë, për shkak të varësisë së tyre në lëndën e parë që vinte nga Serbia, si dhe për importuesit e produkteve finale. Deri para tarifës, Serbia ishte partneri kryesor tregtar i Kosovës. Përveç nevojës për të zëvendësuar produktet e importuara nga Serbia, bizneset janë përballur edhe me rritje të kostos së transportit, meqë vendet si Bullgaria, Sllovenia e Turqia, të cilat kanë zëvendësuar kryesisht produktet serbe në Kosovë, janë në distancë më të largët nga Kosova. Për palët tjera, bizneset vendore të cilat nuk varen nga lënda e parë e prodhuar në Serbi si dhe importuesit të cilët importojnë nga vendet tjera, tarifa ka paraqitur mundësi për rritjen e prezencës së tyre në treg. Po ashtu, përveç rritjes së kostos së transportit, nëse kërkesa në treg nga konsumatorët ka mbetur e njëjtë edhe pas taksës, siç edhe reflektohet në vlerën e rritur të importeve, dhe oferta ka qenë e kufizuar, kjo ka ndikuar në rritje të çmimeve të produkteve në Kosovë nga prodhuesit dhe shitësit.

Në vitin 2019, bazuar në indeksin e harmonizuar të çmimeve të konsumit, në Kosovë kishte një rritje mesatare të çmimeve prej 2.7%. Rritjen më të theksuar e kishin çmimet e ushqimit dhe pijeve me rreth 5.4%. Meqë Kosova është varur në të kaluarën në masë të madhe nga importet nga Serbia, sidomos për produktet ushqimore siç tregon edhe Tabela 1, dhe meqë produktet ushqimore kanë një peshë të theksuar në shportën e konsumatorit në Kosovë, më poshtë kemi analizuar ndikimin e tarifës 100% në çmimet e ushqimeve.

Siç tregon Figura 3, çmimet e ushqimit dhe pijeve në Kosovë, të shprehura përmes indeksit të çmimeve të konsumit, pas vënies së tarifës 100%, janë rritur për rreth 6.1% në periudhën janar - shtator 2019 krahasuar me periudhën e njëjtë 2018, që ishte edhe rritja më e lartë nga viti 2017. Rritja e çmimeve ishte e menjëhershme dhe më dominante në gjashtëmujorin e parë pas vënies së tarifës. Në pjesën e dytë të vitit 2019, vërehet një tendencë rënëse e çmimeve krahasuar me periudhën e njëjtë 2018, mirëpo çmimet përsëri kanë qenë më të larta për rreth 3.3% Sa i përket çmimeve të importit, siç tregon edhe indeksi i çmimeve të importit të ushqimit dhe pijeve në Figurën 3, ato në mesatare kanë qenë stabile nga fundi i vitit 2017, pra pa ndonjë rritje apo ulje të theksuar. Në periudhën janar - shtator 2019 ato janë rritur vetëm për 0.33% krahasuar me 2018. Figura 3 shpërfaq një dallim të theksuar mes çmimeve mesatare të importit dhe çmimeve të tregut për produktet ushqimore.


**Figura 3.** Ndryshimi i çmimeve të ushqimit dhe pijeve krahasuar me vitin paraprak, indeksi i çmimeve të importit dhe konsumit, TM2 2017-TM4 2019



Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e ASK

Për shkak të përbërjes nga shumë produkte të indeksit të importit për ushqim dhe pije, është e nevojshme të bëhet një analizë me e detajuar e disa produkteve. Disa nga produktet në të cilat kanë qenë ngritjet më të mëdha të çmimeve gjatë periudhës janar - tetor 2019 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak janë perimet, drithërat, kafja dhe mishi. Në rastin e perimeve, drithërave dhe mishit rritja e çmimeve të konsumit është përcjellur edhe me rritjen e çmimeve të importit, ndërsa tek kafja vërehet se përkundër që ka pasur një rënie në çmimin e importit gjatë periudhës janar - tetor 2019 krahasuar me 2018, çmimet e konsumit kanë pësuar ngritje. Ngjashëm edhe për produktet e duhanit dhe sheqerërave, nuk ka pasur ndryshim në çmimet e importit, mirëpo ka rritje të çmimeve të konsumit. Produktet më lartë kanë peshë të theksuar në importet totale dhe shportën e konsumatorit. Por ka raste kur çmimet e konsumit janë rritur më pak se çmimet e importit ose kanë pësuar rënie sikurse tek pemët dhe qumështi. Mirëpo, këto produkte, siç tregon edhe Figura 4, vërehet se kanë lëvizje të mëdha në çmime përgjatë viteve.


**Figura 4. Ndryshimi i çmimeve të konsumit dhe importit për disa produkte, 2016-2019**



Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e ASK dhe Doganës së Kosovës

Po ashtu, të dhënat lidhur me çmimet mesatare për ushqim dhe pije në Bashkimin Evropian (BE), nga vijnë edhe disa nga partnerët kryesorë tregtarë të Kosovës, sikurse Gjermania, Sllovenia, Greqia, tregojnë se ndryshimet mujore të çmimeve në BE krahasuar me vitin paraprak kanë qenë të vogla, dhe nuk ka pasur ngritje të hovshme të tyre përgjatë vitit 2019 sikur në rastin e Kosovës. Po ashtu, siç tregon Figura 5, çmimi mesatar i naftës në botë gjatë vitit 2019 ka pësuar rënie krahasuar me 2018. Kjo paraqet një përparësi për importuesit nga Kosova, pasi që ata nuk kanë pasur rritje të shpenzimeve të transportit që ndikohet nga çmimi i naftës. Rritja ka mund të reflektohet vetëm nga distanca më e largët e vendeve nga ku ata importojnë pas vënies së tarifës 100% nga Kosovë, nëse origjina e produkteve të importuara nga ata më herët ka qenë në Serbi. Por, në një masë të theksuar kosto e transportit ka mund të stabilizohet nga rënia e çmimit të naftës. Të dhënat me lartë tregojnë po ashtu se burimi i rritjes së çmimeve të disa produkteve duhet të jetë nga furnizuesit dhe prodhuesit brenda Kosovës, të cilët pas tarifës 100% përballen me më pak konkurrencë dhe kërkesë më të madhe, konkretisht rritje e margjinës së fitimit të tyre.

**Figura 5.** Ndryshimi i çmimeve të ushqimit dhe pijeve krahasuar me vitin paraprak dhe çmimi i naftës, shkurt 2018 - dhjetor 2019



Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e Eurostat, Bankës Botërore dhe ASK

## Heqja e tarifës për lëndën e parë

Qeveria aktuale, konkretisht kryeministri Kurti, në shkurt 2020 ka prezantuar propozimin për heqje të tarifës 100% për lëndën e parë që importohet nga Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina duke filluar nga 15 marsi 2020.<sup>15</sup> Si hap i dytë ishte propozuar heqja e tërësishme e tarifës për të gjitha produktet nga këto dy vende nga 1 prilli 2020 për një periudhë prej 90 ditësh. Mirëpo, edhe pse ka kaluar afati në fjalë, qeveria nuk ka marrë vendim për heqjen e tarifës në lëndën e parë dhe tarifa mbetet ende në fuqi. Në rast se ndodhë heqja e tarifës për lëndën e parë, në aspektin ekonomik ajo paraqet hap pozitiv për shkak se lënda e parë përdoret në krijimin e një vlerë të shtuar, konkretisht në prodhimin e produkteve finale. Për prodhuesit e Kosovës, ulja e kostos së lëndës së parë është ndihmesë e madhe në rritjen e konkurrueshmërisë. Sipas të dhënave të Doganës së Kosovës<sup>16</sup>, Kosova ka importuar nga Serbia lëndë të parë në vlerë prej 28 milionë eurove gjatë vitit 2018. Në grupin e produkteve kryesore të importuar si lëndë e parë, siç tregon Tabela 4, janë gruri, llamarinë, hekuri dhe çeliku, letra e të tjerë. Një vlerë e ngjashme e lëndës së parë pritet të importohet nga Serbia edhe gjatë vitit 2020, pra duke i rritur importet krahasuar me 2019. Importet do të mund të rriteshin në shkallë shumë më të lartë, nëse qeveria e ndjek planin e saj për heqjen e tërësishme të tarifës gjatë 2020.

**Tabela 4.** Produktet kryesore të importuara si lëndë e parë nga Serbia gjatë 2018

	Vlera e importuar		Vlera e importuar
Grurë (jo durum)	11,087,340 €	Bitum nafte	542,964 €
Grurë durum	2,635,407 €	Bakri	491,622 €
Hekuri dhe çeliku	2,508,920 €	Misër	420,217 €
Fuçitë/bidonët, kazanët prej alumini	2,254,338 €	Kartonet, kutitë dhe valixhet, prej letre apo prej kartoni	231,345 €
Llamarinë prej çeliku jo të lidhur	1,846,792 €	Bërsitë dhe mbetje të tjera të forta	151,656 €
Letër dhe karton	798,367 €	Testliner (vizues tabele i ricikluar)	163,906 €
Vaj ushqimor, i pa përpunuar	659,179 €	Letër me krep dhe tekstil prej fibrave (indeve) celulozike	156,580 €

Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e Doganës së Kosovës

<sup>15</sup> Zyra e Kryeministrit. Kryeministri Kurti: Nga 15 mars 2020, hiqet tarifa për lëndën e parë që importohet nga Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina. Burimi: <https://bit.ly/2vfF2XA>

<sup>16</sup> Të dhënat janë pranuar përmes kërkesës.

## Përfundim

Qeveria aktuale, ka propozuar një nismë për heqjen e tarifës 100%, fillimisht në lëndën e parë e më pas në tërë produktet. Nga 21 nëntori 2018, Kosova aplikon tarifë 100% për produktet që importohen nga Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina (BiH). Kësaj tarife i kishte paraprirë masa e mëhershme ku aplikohesh 10% tarifë në produktet e importuara nga këto dy vende. Vendimi për aplikimin e tarifës 100% ishte kryesisht i karakterit politik. Kjo analizë vlerëson ndikimin e tarifës 100% në prodhimin dhe çmimet e produkteve në Kosovë.

Të gjeturat e analizës tregojnë se importet e produkteve nga Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina kanë rënë drastikisht pas hyrjes në fuqi të tarifës 100%, ndërsa eksportet e Kosovës drejt këtyre vendeve kanë pësuar rënie më të lehtë. Po ashtu, vërehet se ka një rritje të aktivitetit në sektorin e prodhimit por që është jo e theksuar. Në periudhën janar - tetor 2019, ky sektor kishte rritje për 10%, ndërsa në periudhën e njëjtë në vitin 2018, rritja e industrisë përpunuese ishte 16%. Por, një ndikim më i theksuar i tarifës 100% vërehet në çmimet e produkteve në Kosovë gjatë vitit 2019. Rritjen më të madhe e kishin çmimet e ushqimeve dhe pijeve të cilat janë rritur për rreth 6.1% në periudhën janar - shtator 2019 krahasuar me 2018, që ishte edhe rritja më e lartë nga 2017. Burime të rritjes së çmimeve të disa produkteve dalin të jenë qoftë rritja e çmimeve nga prodhuesit dhe bizneset importuese për shkak të uljes së konkurrencës dhe rritjes së kërkesës apo rritjes së kostos së transportit.



European  
Union  
Kosovo


Ky publikim është botuar me asistencë të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Institutit GAP dhe Kosovo 2.0 dhe në asnjë mënyrë nuk mund të paraqes pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Projekti “Inovacioni për mediat e qëndrueshme dhe angazhimin qytetar” implementohet nga:

INSTITUTI GAP  
GAP INSTITUTE



KOSOVO 2.0







European  
Union  
Kosovo

**Ndikimi i taksës 100%  
në prodhim dhe çmime të  
produkteve në Kosovë**  
Periudha krahasuese:  
janar - tetor 2019 dhe  
janar - tetor 2018

KOSOVO 2.0

INSTITUTI GAP  
GAP INSTITUTE 

---

Mars 2020